



## PËRMBLEDHJE E MINUTAVE TË TAKIMIT

### KËSHILLI KOMBËTAR PËR EKONOMI DHE INVESTIME (KKEI)

#### DISKUTIM MBI ZBATIMIN E LIGJIT No. 08/I-125 PËR PRONËN PUBLIKE

Prishtinë, 7 mars 2025, 09:00 – 12:00

Takimi u moderua nga Drejtuesi i Sekretariatit Artan Mehmeti. Në takim morën pjesë 24 pjesëmarrës, që ishin përfaqësues të bizneseve vendore dhe institucioneve shtetërore në Kosovë.

#### Fjalët hyrëse

**Artan Mehmeti, Sekretariati, KKEI**, në fjalën e tij hyrëse përshëndeti dhe falenderoi pjesëmarrësit që janë bashkuar në raundin e radhës të takimeve sektoriale për këtë vit, e që është vazhdimësi e takimit të fundit lidhur me këtë temë. Vazhdoi tutje duke shpjeguar për rëndësinë e Sekretariatit të Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime (KKEI), që është një platformë e dialogut publik-privat që synon të afrojë institucionet publike me sektorin privat dhe të përmirësojë klimën investuese, qeverisjen dhe transparencën.

Sekretariati mbështetet nga SECO përmes Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

#### **Tea Blakaj, Këshilltare Juridike, ZKM**

Të gjitha institucionet shtetërore duhet ta vazhdojnë punën e tyre në bazë të ligjeve që rregullojnë punën e tyre.



- Qëllimi i Ligjit për Pronën Publike është krijuar në mënyrë që të mbrohet prona publike sa më shumë që është e mundur.
- Arsyeshmëria e këtij ligji është: prona publike duhet të shfrytëzohet së pari në interes publik, sepse në të kaluarën jemi ballafaquar me kërkesë sic është ajo e ME për ankandin solar ku nuk ka pasë bazë ligjore që t'u jepet prona publike në shfrytëzim. Dmth, aplikimi procedurës mbetet i njëjtë vetëm se dosja për aprovim dërgohet te ne, te Divizioni për Pronën Publike në ZKM. Do të ishte më së miri që të prezantohet Rregulloja që të shohim si është rregulluar puna e divizionit dhe cka do të thotë kjo për Pronën Publike, po ashtu edhe për bizneset.

### **Ekspert Ligjor**

Ligji për Pronën Publike kërkon që të miratohen tre akte nënligjore që shumë prej akterëve I kanë parë si pjesë pa të cilën nuk mund të vihet në zbatim Ligji për Pronën Publike. Janë këto tri rregullore për të cilat edhe do të flasim në detaje:

1. Rregullore për kushtet për bartjen e pronësisë të Pronës Publike dhe dhënia me qera e sendëve në Pronësi Publike.
2. Rregullore për organizimin e brendshëm dhe funksionimin e Zyrës për administrimin e Pronës Publike në Zyrën e Kryeministrit dhe
3. Evidenca unike e regjistrimit të Pronës Publike.

Janë dy gjana kryesore që Rregullorja për kushtet e bartjes të Pronës Publike i rregullon, e ato janë

1. Kushtet që duhet plotësuar kur një institucion të vendos ta bartë një pronë publike ose ta jep me qera dhe
2. Procedura që duhet ndjekur nëse jepet ajo pronë me qera.

Procedurën e përcakton vet ligji ku shkruan: *“Përmes procedurës dhe ankandit përkatësisht të grumbullimit të ofertave dhe përjashtimisht me marrëveshje të drejtpërdrejtë”*.

Të diktutojmë për procesin duke filluar me APK-në e pastaj me insitucione e tjera relevante.



- **Pyetje për APK:** Si fillon procesi? A e bëni shpalljen apo pranoni kërkesë prej subjekteve privatë që kanë shpallur interesim për ndonjë pronë të caktuar?
- **Përgjigje, APK:** Me kërkesë nga subjektët apo persona fizik/juridik. Atëherë pasi ta pranoni kërkesën – sipas kësaj rregullore - duhet ta përcjellni te kjo Zyrë ku edhe e jep pëlqimin parimor, duke bërë intersim te të gjitha organet e tjera shtetërore se mos kanë interesim strategjik apo ndonjë interes tjetër mbi atë pronë publike. Pas pëlqimit agjensitë dhe ministritë e ndryshme mund të fillojnë me procedurë. Po e shoh një problem që duhet ta trajtomë sot, të themi nëse unë si zyrë apo Albërita (Hyseni) si zyrë ta japim pëlqimin parimor, por kur të ktheheni në Agjenci, Ligji e imponon që të udhëhiqet një procedurë e ankandit ku ky Ligj i ka kushtet e veta, por ka edhe raste përjashtuese është mirë të diskutojmë se sa janë konform nevojave dhe kërkesave.

### **Departamenti i Minierave dhe Mineralëve, Ministria e Ekonomisë**

Sektori minërar ka të bëjë me pronën publike dhe jo me sendët në tokën publike. Ky sektor ka inters të shfrytëzimit të pronës publike, tokës konkretisht në afat shumëvjeçar dhe vlera e investimëve është shumë e madhe. Planifikimet minërare janë mbi cdo strategji tjetër.

Procesi është me aplikim. Shprehët interes për zonë e lirë. Në komisionin ë pavarur mirret zona që është e lirë, sepse nuk bën të ketë licencë mbi licencë.

### **Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve**

Sqarim lidhur me procedurat se si duhet të mirret licencë te KPMM. Këto nuk rregullohet me procedura të ankandeve publike. Janë dy forma:

Procedura: i pari për nga koha, i dyti për nga e drejta.

- Së pari e merr lincencën për hulumtim për të parë nëse ajo zonë është e pasur me minerale apo jo pavarësisht llojit të mineralit. Nëse hulumtimi rezulton pozitiv atëherë fillon procedurat për ta pajisur me licencë të shfrytëzimit që nënkupton të drëjtën e shfrytëzimit të atyre mineraleve.
- KPMM dhe APK kanë pasur një bashkëpunim tejet të mirë përmes një Memorandumi të Bashkëpunimit, në mënyrë që të dy institucionet të jenë në koordinim me njëra tjetrën. Duhet të përcaktohen disa kritere se në cilat raste duhet të përjashtohet një



operator ekonomik dhe të mos i jepët licenca nëse ai zhvillon të gjitha procedurat dhe merr një licencë nga KPMM ose një vendim.

- **Pyetje, Vigan Sylejamani, Sharrcem:** Në çfarë faze lëshohet pëlqimi parimor?
- **Përgjigje, Ekspërt Ligjor:** në fazën fillestare lëshohet pëlqimi preliminar. Në draftrregullore ideja e pëlqimit preliminar është që të shifet nëse institucionet tjera kanë interes strategjik zhvillimor mbi atë tokë apo send të caktuar. Nëse pëlqimi preliminar kthehet mbrapa institucioni/agjencioni vendos që t'i zhvilloj procedurat e veta sipas kësaj rregulloreje ose ligjet përkatëse që i ka në fuqi.

Terminologjia në këtë ligj është pak problematike sencka nënkupton cka në disa raste. Për bartje nga një institucion të tjetri institucion e kur është puna te dhënia me qira atëherë është pozitive, pastaj shkruan dhënia e sendëve me qira të sendëve publike.

**Sqarim, Departamenti i MM, ME:** kompanitë nuk aplikojnë që të pajisën me sende, por aplikojnë për shfrytëzim të pronës publike dhe jo për sende në pronë. Kërkësa për shfrytëzim të pronës bëhet për jëtëgjatësi të madhe ku ka licenca 20, 25 dhe 30 vjet.

### **Agjencia Pyjore e Kosovës (APK)**

Pika e parë ku thotë: kur ekziston interesi publik për bartjen e pronës në pronë publike

- **Pyetje** Cila pronë do të bartët në pronë publike për dhëniën me qëra të sendëve? Kjo është shumë e paqartë. Është dispozitë që ngre konfuzion. Nuk e ka as logjikën juridike e as gjuhësore. Këto duhen të sqarohen mirë.

APK momentalisht ka dy grupe kërkesash: njëni grup ka 2500 kërkesa të ushtruara dhe mbi 600 kërkesa të grupit tjetër dhe ka 200-300 kërkesa për vazhdim të kontratave të cilat kanë skaduar dhe ka një kohë që nuk është punuar në këtë drejtim. Në mënyrë që të merrën pëlqime më këtë procedurë, këto kërkesa duhet të dërgohen te kjo zyrë, por pyetja është kush janë ata zyrtarë që mund t'i ekzekutojnë që t'i përfundojnë afatet ligjore.

Thuhet se janë dy procedura dhe nuk dimë se kush do të mirret me këto, e ato janë:

1. Bën kërkesë subjekti dhe
2. Hap ankand.



## MBPBZHR

Ligji për Pyje dhe Ligji për Pronë Publike janë në kolizion. Nuk ka pas konsultim publik kur është hartuar Ligji për Pronë Publike.

### Agjencia e Pyjeve të Kosovës (APK)

Janë 1.000 kontrata aktualisht. 200 kontrata janë ku investitorët kanë investuar miliona euro. Pyetja është: si hapet ky ankand të këta investitor? Nëse një operator ekonomik është i vendosur në vend publik a mundemi më kërkesën e tij të hapim ankand publik në vendin ku është aktualisht i vendosur apo me një procedurë mund t'i zhvendosim?

- **Përgjigjez Vigan Sylejmani, Sharrcem:** Shkaku natyrës së biznesit, ne nuk kemi asnjë interes që të marrim pjesë në një ankand sa i përket tokave në shfrytëzim, sepse nuk ka asnjë sens logjik.

### Reagim / Propozim, Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineralëve

**Reagim:** te sektori minerar nuk ka mundësi të hapen ankande në aspektin klasik të ankandëve, sepse aplikohen procedurat sipas Ligjit të Minierave. Kjo nënkupton së lincenca i lëshohet atij që i plotëson kushtet sipas ligjit dhe kualifikohet si person që ka të drejtë të ketë qasje në atë pronë publike.

Kur kemi të bëjmë me atë se kur ekziston interesi publik. Interesi publik ekziston kur i plotëson kushtet ligjore dhe se kjo duhet të kthehet në terma më konkret që të kuptohet se te sektori minerar ose te lëshimi i kontratave në shfrytëzim për sektorin minerar – këtu themi së është interesi publik nëse plotësohen kushtet e Ligjit bazik që është Ligji për Miniera dhe Minerale. Në të kundërtën krijohet paqartësi. Mund të krijohet situatë ku ndokush aplikon për licencë dhe pastaj të hapet ankand publik dhe nëse hapet ankandi në ato raste ia pamundëson atij që ka marrë licencën që ka plotësuar kushtet sipas ligjit për të marrë një të drejtë. Këto janë dy procedura që duhet të qartësohen në mënyrë që të evitojmë bllokadë në të ardhmën.

**Propozim:** procedurat të ndjekën sipas Ligjit për Pyje sic ka qenë deri më tani dhe të përjashtohen nga këto procedura të tjera, vetëm në rastet kur i duhet një pëlqim ose dhënie e pëlqimit paraprak për ndonjë projekt tjetër dhe që mund të koordinohen këto



dy institucione mes vete. Në të Kundërtën, nëse krijohen me procedura të vecanta ku duhet të zhvillohen paralelisht dy procedura, atëherë do të kemi probleme për të cilat nuk do të mund të realizojmë deri në fund një procedurë administrative.

### **Ekspert Ligjor**

Baza kryesore është Neni 17. 8 parasheh që *“kontrata që lidhet në kundërshtim me këtë nen është e pavlefshme”*, kurse te Paragrafi 1 po i këtij neni aty mundësohet marrëveshje e drejtëpërdrejtë. I lejohe institucioneve të shkohet drejtëpërdrejtë. Prapë se prapë nuk po mund t’i ikim këtij pëlqimi preliminar.

**Pyetje për APK-në:** kur parashtrahet kërkesa prej APK-së te Zyra e administrimit publik për të marrë pëlqimin preliminar për cka mund të bëni marrëveshje të drejtëpërdrejtë, sepse ua lejon edhe Ligji edhe Rregullorja - a është kjo zgjidhje e pranueshme për ju?

**- Përgjigje, APK:** Së pari duhet të shohim cilat janë specifikat e pyjeve dhe tokat pyjore në Kosovë me të cilat menaxhohen dhe administrohen përmes Ligjit të Pyjeve. Kemi shumë sektorë që zhvillohen në këto toka pyjore, ato minerar, bujqësisë, blegtorisë, turizmi malor.

**Pyetje:** Nëse kemi një fermer që parashtron kërkesë për shfrytëzimin e 1ha kullosë çfarë procedura duhet ndjekur në këtë rast deri në marrje të një kontrate? Cilat janë politikat që ne duhet të ndjekim në raport me ata që janë në zonat rurale?

### **Pyetje, Artan Mehmeti, KKEI**

Nëse njësia nuk ka kapacitet që të caktojë një afat kohor, atëherë kjo konsiderohet si pëlqim i dhënë.

**- Përgjigje, APK:** Sqarimi që është dhënë këtu, nuk konsiderohet i tillë. Konsiderohet kur ZKM ia dërgon organeve tjera dhe ato nuk kthejnë përgjigje për 15 ditë, atëherë konsiderohet e miratuar. Por, jo kjo e para.

### **Agjenica e Pyjeve të Kosovës (APK)**

Pika e parë që duhet të diskutohet është *kompetenca ligjore*.

**- Pyetje:** A ka AKP -ja kompetencë ligjore t’i zbatoj këto Rregullore nëse aprovohen?



Ne kemi një opinion që ka kolizion mes ligjeve. Këto ligje duhet të harmonizohen.

## **MBPZHR**

Kemi dërguar dy opinione, atë të APK-së dhe atë të Ministrisë së Drejtësisë të ZKM-ja për cka është përgjigjur se këto dy ligje janë në kolizion mes vete.

## **Zyra Ligjore, ZKM**

Kemi konstatuar që ka kolizion ligjor, por tash janë vetëm dy zgjidhje, ai që është më i gjatë që kërkon procedurë dhe opsioni afatshkurtër që të gjejmë një interpretim ashtu që brenda Ligjit për Pronën Publike të shohim hapësirën për nxerrjen e këtyre akteve nënligjore dhe zhblokimin e këtyre procedurave.

Ne si Zyrë Ligjore kemi punuar me ekspertin (Albert Avdiu) dhe kolegët në këtë rregullore për njësinë që e përcakton Neni 25. Synimi është që të arrihet në afat të shkurtër zhblokimi i këtyre procedurave që janë në pritje. Në planin afatmesëm domosdosmërisht kërkohet që të ndryshohet Ligji për Pronën Publike, në mënyrë që dispozitat që janë kolizive të rishikohen.

Të çështja e qirasë: dispozita ka lënë opsione ashtu që kemi mundësi për të ofruar një zgjidhje.

Sa i përket pëlqimit, është e domosdoshme që të lëshohet prej Zyrës, derisa të rishikohet ligji duhet të zbatohet që është normë imperative dmth asesi e diskutueshme.

## **Pyetje për ZL/ZKM nga Eksperti Ligjor**

- A është në rregull me hy në dispozita kalimtare? Sepse, ka një konsensus që të rishikohet ky Ligj.
- A mund me dispozita kalimtare të thuhet se “pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji dhe jo më vonë se tre apo gjashtë muaj, Zyra të mos bëj verifikimin nëse ndonjë institucion ka interes, por ta jep pëlqimin preliminar *prima facie*?
- Pas gjashtë muajve mund të indentifikojmë defektet më të mëdhaja pastaj.

## **Zyra Ligjore, ZKM**



Të pjesa që Zyra t'i drejtohet insitucionëve tjera që të shohim nëse kanë plane nëse prona do të shfrytëzohet në të ardhmën, kjo nuk është përcakuar në ligj. Ndoshta mund ta lëmë një dispozitë tranzitore që *“dizpozitat e caktuara fillojnë të zbatohrn pas tre muajve”*, në mënyrë që pas tre muajvë të lëshohet një pëlqim parimor, kjo si zgjidhje më e shpejtë.

### **Ekspert Ligjor**

Nuk e di sa është e pranueshme një zgjidhje e tillë, por që pëlqimit parimor nuk po mundemi t'i ikim, sepse ligji e kërkon.

- **Kundërpërgjigje, APK:** nga ajo që u tha, ne ende kemi dilema se cili institucion mund të vendos kontratë. Cili institucione është kompetent?

### **Përgjigje për APK-në, Tea Blakaj, Këshilltare Juridike, ZKM**

Para disa muajve në MD gjatë një takimi shumë mirë e kemi thënë: Agjencia e Pyejeve e ka Ligjin e vetë dhe mandatin e vet duhet ta zbatoj. Krejt cka po kërkohet me këtë Ligj është që ju ta merrni një pëlqim në parim dhe është vetëm në parim.

Ne do të propozojmë ndryshim të Ligjit, por deri te ndryshimi duhet të bëhet dicka, prandaj zgjidhja është kjo: ju veproni në bazë të Ligjeve të juaja. Pasi ta përfundoni lëndën e sjellni për të marrë një pëlqim në parim. Bizneset dhe insitucionet vazhdojnë të punojnë sikur deri tash, nuk ka ndryshime. Është vetëm një division i ri që duhet të thotë: a ka ndonjë interes më të madh këtu apo jo? Jua dërgon pëlqimin dhe ju mund të vazhdoni.

### **Ekspert Ligjor**

Ligji për Pronën Publike, Neni 17 i jep dy afate të caktuara.

- Deri në 15 vjet nëse jepet me qera atëherë vendos Qeveria. kurse,
- Nëse jepet më shumë se 15 vjet duhet të vendos Kuvendi.

Është problem praktik te këto kontrata se më herët u tha që ka kontrat 20, 23 e 40 vjeçare.

**Pyetje:** Si duhet të trajtohet kjo?

**Agjencia e Pyjeve të Kosovës (APK)**





As në Ligji e as në këto Rregullore nuk janë të sqaruara procedurat. Ne duam të dimë cilat janë procedurat, sepse nuk duam të futemi në paqartësi tjetër.

**Pyetje:** A duhet të hapet ankand për këto kërkesa që i kemi apo nuk duhet të hapim ankand? A mund t'i marrim direkt ato, pa vendim të Qeverisë?

Ky Ligj është aprovuar në vitin 2023, e që as ekspertët aktual nuk kanë pasë dorë në këtë ligj.

### **Zyra Ligjore, ZKM**

Nëse duhet t'i përgatisim këto tri akte nënligjore brenda kësaj kornize ligjore dhe si mund ta zhbllokojmë këtë proces të aplikimit.

Sa i përket çështjes së ankandit, Nëni 17.1 është më fleksibil. Kjo është zgjidha për një afat të shkurtër, kurse për afatgjatë do ta rishikojmë ligjin bashkë me MD ku do t'i bëjmë një analizë.

### **Ekspert Ligjor**

Meqë është e pamundur që të eliminohet ky ngërç, duhet ta bëjmë sa më pak të dhimbshëm përmes këtyre akteve nënligjorë.

### **Pyetje, Artan Mehmeti, KKEI**

A ka ndonjë zgjidhje tjetër se si duhet të shkohet përpara derisa të aprovohet Ligji?

- **Përgjigje MBPZHR:** Një opinion ligjor që lëshohet nga ministri Faton Peci, që nuk e shkel asnjë ligj kur nënshkruan udhëzime administrative të Ligji për Pyje që mundësojnë dhëniën e tokave me qira përmes Ligjit për Pyje. Kjo Rregullore kalon.
- **Pyetje:** Cili është akti më i lartë që duhet një ministri ta respektoj dhe të ketë kujdes që mos ta shkel?
- **Përgjigje Tea Blakaj, ZKM :** Ligji për Pyje i kërkon disa akte ligjore. Krejt cka ju duhet juve është të kërkonit një aprovim në parim. Prandaj bllokada është e papranueshme. Prej të mërkurës kur të aprovohet kjo Rregullore, ne i zhbllokojmë bizneset.



- **Kundërpërgjigje APK:** APK-ja nuk e ka bllokuar, por ai Ligj ka shkaktuar këtë bllokadë. Neve na kanë bllokuar ligjet që na kanë ardh të miratuara. Ne vazhdimisht kemi bërë kërkesa të ZKM-ja, por asnjëherë nuk e ka zhblokuar këtë punë askush.
- **Kërkesë:** Të bëhen disa përjashtime nga hartuesit për kërkesat dhe sqarime se si duhet të sjellët APK-ja për t'u bërë zhblokimi. Të përcaktohen mirë obligimet e Agjencisë.

#### **Pyetje, Artan Mehmeti, KKEI**

A është e majftueshme vetëm të shënohet që vazhdon si ka qenë dhe më herët?

- **Përgjigje APK:** mundet të thuhet: "APK-ja vazhdon me mandatin e vet ligjor" dhe me kaq përfundon. Me këto Rregullore duhet të bëhen përjashtime të caktuara për pyje dhe toka pyjore.
- **Përgjigje Ekspert:** janë tri momente në procedurë që nuk mund t'i ikim këtij ligji.
- **Pyetje, APK:** a do të merret vendim në Qeveri në bazë të Nenit 17.2
- **Përgjigje, ZL/ZKML:** patjetër që po.

#### **Ministria e Ekonomisë**

Jemi dukë pritë një vendim që është shumë i rëndësishëm e që është për ankandin e verës, sepse, ky Ligj është në kolizion edhe për Ligjin për BRE-të. Komentet do t'i dërgojmë gjatë ditës.

#### **Pyetje, Vigan Sylejmani, Sharrcem,**

Përse ka nevojë dicka mu përjashtu nëse nuk është paraparë? Përse duhet të zhvilloj procedura të ankandit APK-ja për një tokë publike? Kur është e drejtpërdrejtë dhe kur është ankand?

- **Përgjigje, Ekspert Ligjor:** për procedurat e ankandit është rregulli, kurse përjashtimi është marrëveshja e drejtpërdrejtë.

E drejtpërdrejtë është në dy kushte: 1. Nëse Ligji përkatës e lejon dhe 2. Jane specifikat për fushëveprimtarinë e caktuar. Nëse nuk ka logjikë atëherë shkohet më marrëveshje të drejtpërdrejtë.

#### **Pyetje, Shoqata e Përpunimit të Drurit të Kosovës (SHPKD)**



Kur erdhën këto probleme, pas këtij ligji apo kanë ekzistuar edhe më përpara?

- **Përgjigje, APK:** pas këtij ligji.

**Reagim, ShPDK:** nuk e kuptoj përse duhet të komplikohen gjanat që janë shumë të thjeshta, kur i kemi vendet e rajonit që kanë procedura të thjeshtësuara.

### **Departamenti i Minierave dhe Mineralve, ME**

Janë dy ceshtje bazike në sektorin minera, e ato janë: hulumtimi dhe vazhdimi.

Të hulumtimi, Ligji thotë: *“kompania e cila ka realizuar hulumitmin është e para e cila merr licencën dhe nuk ka as garë e as ofertë”*.

Te vazhdimi: kompania e cila e ka pasë pëlqimin për pesë vjet, tash pret ta merr vazhdimin.

**Sqarim:** Te sektori minerar kompania e merr pronën për shfrytëzim dhe jo me qera.

### **Ministria e Ekonomisë**

Pika.3 ku flitet për ofertim konkurues, nëse ky vendim obligohet në bazë të kësaj Rregullore, kjo na prish punë neve si ministri në ankand, apo jo?

- **Përgjigje, Tea Blakaj, ZL/ZKM:** me sa e kam kuptuar jo, sepse investitorët veq i kanë bërë matjet më përpara.
- **Reagim, APK:** vendimi lidhur me ankandin e ërs ka dy pjesë kryesore: njëna është që e ndalon APK-në për vazhdimin e procedurës për tokën me qera dhe në anën tjetër duhet të kualifikohesh së pari pastaj të merrni pëlqimin te APK-ja.

### **Ekspert Ligjor**

Sa i përket hulumtimit dhe zgjatjes së kontratës ekziston mundësia ë drejtpërdrejtë. Problemi është te 15, 99 që duhet të sqarohet mirë. Duhet ta lehtësojmë procedurën byrokatike që është bërë pengesë për biznese.

Sa I përket manovrimit ligjor: ne do ta lëmë një dispozitë të përgjithshme që I përjashton prej atij procesi të marrjes së verifikimit prej institucioneve tjera. Ato 2500 kërkesa që dërgohen në Zyrë do t'i kthej me vendim për pëlqim preliminar.



## Pyetje, Ministria e Ekonomisë

A mund të përfshihet një klauzolë në Rregullore të cilat projekt e enërgjisë i referon në vendim të kryeministrit, ku nuk e obligon ankandin e ërës t'i në shtrohet këtyre procedurave.

- **Përgjigje, Tea Blakaj, ZKM:** Rregulloja të cilën e ka punuar eksperti (Albert Avdiu) së bashku me Zyrën Ligjore të ZKM-së e përcakton procedurën të cilën duhet ta ndjek divizioni.
- **Kundërpërgjigje, ME:** Ligj është problematik, ashtu që kërkoj që Rregullorja ta rregulloj çështjen për BRE-të.
- **Përgjigje, Ekspert Ligjor:** Ligji për Pronën Publike, Neni 17 shkruan: *“kontrat e lidhura me këtë nen, janë të pavlefshme”*
- **Kundërpërgjigje, APK:** nuk është çështje e kontratës, por çështja e procedurës. Ku duhet të merret pëlqimi paraprak? Sipas vendimit të Qeverisë merret te Agjencia paraprakisht.

## Pauzë

### Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës (DHTIK)

Kërkoj nga paneli që ta kenë parasysh gjendjen e biznesëve në të cilën ata gjenden tash për tash.

**Propozimi:** Procedura e cila është ndjekur të kërkesa e biznesëve tona të vazhdohet sic është e paraparë me Ligjin për Miniera dhe Minerale dhe Ligjin për Pyje.

Me këto Rregullore të propozuara nuk po duket se do zgjidhet problemi. Kjo vetëm e komplikon çështjen. Duhet të përmendet në mënyrë eksplicite se për cila raste vlen kjo.

- **Kundërpërgjigje, Ekspert Ligjor:** Neni 17.2 e thotë *“mënyrën kryesore, por jo të vetmën”* dhe ke Nenin 12 *“ke marrëveshjen e drejtpërdrejtë”* të kushtet e Rregullorës. Dhe qëllimi i Nenit 12 është për shkak të Nenit 17, sepse Ligji të lejon mundësinë që edhe kur të prishen kushtet (e institucionit) mund të shkojnë me marrëveshje të drejtpërdrejtë.

## Agjencia e Pyjeve të Kosovës



Neni 7 “*dhënia me qira e sendëve*” nuk kuptohet se kush janë sendet. Për hartimin e këtyre tri Rregulloreve ka qenë një komison për cka kam qenë pjesë e atij komisioni para tre muajve dhe jemi ftuar vetëm një herë dhe asnjëherë tjetër.

### **Pyetje për AKP-në, Vigan Sylejmani, Sharrcem**

Sipas Nenit 12 - a është e mjaftueshme kjo për juve?

- **Përgjigje, APK:** Kjo nuk është e mjaftueshme për neve, sepse legjislacioni kërkon të merret vendim në Qeveri, për cka Neni 12 këtë nuk e specifikon.
- **Pyetja:** Cilat janë sendët që këto kontrata vendosin për marrjen e tokës pyjore me qera? A janë sende apo janë pronë? - Sepse ne kemi problem edhe me trajtimin e drurit dhe pyjeve, sepse nuk dimë si t'i trajtojmë.

### **Pyetje, Vigan Sylejmani, Sharrcem,**

A mund të shtohet një shtojcë në këtë Rregullore për të definuar se cka është send cka është pronë?

- **Përgjigje, Ekspert Ligjor:** Drafti i parë i ka pasë disa përkufizime në Ligj, mirëpo në diskutim me ministrinë I kemi hjek, sepse ckado që përkufizohet në Ligj mandej nuk mund ta shtjellojmë më tutje.
- **Kundërpërgjigje, Eksperte Ligjore, KKEI:** Ligji ka qënë i mangët edhe për definicione, por edhe ka pasë mospërputhje mes definicioneve dhe tekstit të Ligjit. Nëse e shikoni Nenin 17, për Pronë Publike, nuk kemi mundur të devijojmë shumë prej tekstit të Ligjit, sepse këtu thotë: “*sendet dhe te mirat në pronësi publike jepen me qira*”. Prandaj konsideroj se i përfshin edhe sendet e luajtshme edhe të paluajtshme.
- **Kundërpërgjigje, KPMM:** Te përjashtimi i Nënit 12 ku thotë: “*nëse përcaktohet me Ligj të vecantë*”, mirëpo nuk ka Ligj të vecantë që mënjanon procedurat që rregullohet me Ligjin e Pronës, sepse duhet të specifikohën qartë procedurat.
- **Kundërpërgjigje, Ekspert Ligjor:** Për aspektin mbisundues ky Ligj thotë: “*dispozitat ligjore të ligjeve tjera që janë në konflikt me këtë nuk vlejnë*”. Mirëpo, Neni 17 ta jep mundësinë që thotë: “*sipas legjislacionit përkatës*”. Dmth nëse ka mundësi



për marrëveshje direkte atëherë le ta bën sipas atij legjislacioni. Në momentin që hyn kjo Rregullorë në fuqi atëherë opinionin zhbëhet.

- **Kundërpërgjigje, MBZHR:** Ligji për Pyje bie ndesh me Ligjin për Pronën Publike sipas Nënit 32. Jemi shumë të intersuar për zgjidhje.
- **Kundërpërgjigje, Vigan Sylejmani, Sharrcem:** për të cilin jemi duke diskutuar, mund t'i referohemi Ligjit për Pyje.
- **Kundërpërgjigje, APK:** Secili institucion duhet t'i jep propozimet e veta në mënyrë që kjo Rregullore të jetë në harmoni edhe me procedurat e Ligjit për Pronën Publike edhe me Ligjin për Pyje.
- **Propozim, Artan Mehmeti, KKEI:** javën e ardhshme mund ta caktojmë një tjetër takim dhe të diskutojmë më gjatë për këto specifika në mënyrë që të ktheni përgjigje.
- **Propozim, DHTIK:** Meqë në kuadër të ZKM-së do të ketë një Zyrë me një drejtor, atëherë le të jep udhëzime në formë të opinionit që i përjashton prej përgjegjësisë.

#### **Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve:**

Te Nenii 7, po përcaktohet që edhe xehet janë të mira të përgjithshme të RKS, e bënë edhe aset kushtetues. Ligji jonë e përcakton që xehet janë pronë publike..

- **Kundërpërgjigje, Ekspert Ligjor:** Rregullorja nuk guxon të devijon prej Ligjit. Duhet të ndërrohet ky Ligj në mënyrë që të bëhen ato ndryshime për të cilat ju po i kërkon.
- **Kundërpërgjigje, KPPM:** Dilema është nëse duhet të shkohet me procedura të ankandit sa herë ka të mira apo sipas procedurës së Nënit 12?
- **Kundërpërgjigje, DHTIK:** Patjetër na duhet një zgjidhje.
- **Kundërpërgjigje, MPBZHR:** Për momentin duam zgjidhje të përbashkët, kurse më vonë MD do ta dërgoj Ligjin për plotësim ndryshim. Dërgoni të gjithë ju komentet në bazë të cilave ne do të punojmë deri të martën me ekspertin (Albert Avdiu).
- **Kundërpërgjigje, APK:** APK I ka 300 mijë ha nën menaxhim në Kosovë. Jemi për zgjidhje, por kjo mënyrë kështu nuk e zgjidh problemin.
- **ZL/ZKM:** Askush nuk po e mohon që ligjet janë në kolizion, mirëpo është ultimatum i Kabinetit që të gjindet një zgjidhje e përkohshme derisa të ndryshohet ligji.



- **Pyetje:** ju si APK a mund t'i dërgoni komentet deri të hënën për këto draftregullore?
- **Kundërpërgjigje, APK:** Nevojitet kohë për të gjet një zgjidhje, sepse duhet të trajtohen nen për nen në raport me të dy ligjet.
- **Deprtamenti i MM, ME:** Sa i përket resurseve minerare duhet te na tregoni ku t'i adresojme.

### **Eriola Muhaxhiri, ORGJK**

Ju si institucione të shtetit duhet të dakordoheni mes vete për të mirën e shtetit dhe në këtë mënyrë ndihmohen edhe bizneset që disa janë duke falimentuar disa prej tyre.

### **Pyetje, KPMM**

- Kur duhet të zbatohet Neni 12? Kjo për neve është e paqartë. Nuk mund të zbatohet as të agjencioni I pyjeve e as të KPMM-ja me gjendjen ekzistuese të këtyre rregulloreve.
- **Kundërpërgjigje, Ekspert Ligjor:** Nëse është dilema te Neni 12 e marrim për sipër që ta shtjellojmë më tutje për ta sqaruar se kur dhe si mund ta vëni në zbatim atë nen/dispozitë.
- Ju lutem që të gjithë të I dërgoni komentet dhe tregoni problemin që keni te neni/paragrafi dhe propozimin konkrete.
- **Kundërpërgjigje, APK:** Ne nuk mund të japim komente për një Ligj, e as për rregulloret shpejt e shpejt, sepse nuk është në pyetje vetëm Neni 12.

### **Artan Mehmeti, KKEI**

Të martën takohemi sërish dhe vazhdojmë diskutimin lidhur me çështjet e ngritura